



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut

Ul. Miodowa 10
00-251 Warsaw, Poland

Tel: +48 22 520 06 00
Fax: +48 22 520 06 05

E-mail: PMIR@odhr.pl
osce.org/odihr

Dokument konceptual për Tryezën e Rrumbullakët për Banimin

12-13 shtator 2012

Zagreb, Kroaci

Lidhur me projektin

“Praktikat më të mira për integrimin e romëve” (PMIR) është projekt rajonal për Ballkanin Perëndimor. Ky projekt ka për qëllim që të kontribuojë në integrimin e romëve në shtetet e rajonit dhe në Kosovë*, duke i shqyrtuar zotimet e bëra me qëllim të bashkimit në BE dhe si Shtet pjesëmarrës i OSBE-së. Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian (90%) dhe Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së (10%).

Si pjesë e Planit të Veprimit të OSBE-së për Komunitetin Roma dhe Sinti, strategjinë Dekada e Përfshirjes së Romëve dhe strategjitë qeveritare për integrimin e romëve, qeveritë, organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile rome në Ballkanin Perëndimor janë duke punuar së bashku për promovimin e përfshirjes sociale për romët dhe luftimin e diskriminimit ndaj tyre.

Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerim e BE-së ka mbajtur një sërë konferencash të nivelit të lartë për romët bashkë me të gjitha qeveritë në rajon, që ka rezultuar me një numër konkluzash dhe zotimesh. Që romët të përfitojnë në të vërtetë nga këto, qeveritë duhet t'i shtojnë përpjekjet e tyre dhe të gjejnë zgjidhje inovative. Organizatat e shoqërisë civile, dhe në veçanti OJQ-të rome, duhet të vazhdojnë me aktivitete avokuese për reformim, duke propozuar zgjidhje me përfshirëse dhe duke rritur ndërgjegjësimin lidhur me gjendjen e pakicës rome.

Projekti PMIR do të mbështesë këtë proces përmes promovimit të programeve inovative dhe përmes lehtësimit të bashkëpunimit ndërmjet qeverive lokale dhe qendrore, institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile. Banimi është një nga pesë fushat në të cilat do të punojë PMIR: 1. Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike dhe vendimmarrje; 2. Qasja në ndihmë juridike; 3. Përmirësimet e kushteve të jetës; 4. Luftimi i diskriminimit dhe promovimi i vizibilitetit për komunitetin rom; dhe 5. Bashkëpunimi rajonal.

Objektivi i tryezës së rrumbullakët

Objektivi i tryezës së rrumbullakët është të mbështesë qeveritë dhe shoqërinë civile në përmirësimin e mekanizmave nacionale dhe lokale për legalizimin dhe përmirësimin e vendbanimeve rome. Për shkak se legalizimi dhe përmirësimi nuk janë opsione të realizueshme në të gjitha vendbanimet, tryeza e rrumbullakët gjithashtu do të nënvizojë lidhjet e mundshme me nismat për zhvillimin e banimit social. Duke sjellë në një vend ekspertë nga ministri dhe komuna të cilët do të punojnë në fushën e banimit, kjo tryezë e rrumbullakët do të:

- promovojë një këmbim të përvojave me modele të ndryshme të përmirësimeve të banimit ;
- ofrojë ndërgjegjësim lidhur me zhvillimin e banimit social dhe realizimin e të drejtave të banimit;
- trajtojë vështirësitë në integrimin e romëve përkritazi me zhvillimet në banim.

Pjesëmarrësit

* This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244/99 and the ICJ Opinion on the Kosovo declaration of independence.



Pjesëmarrësit në tryezë të rrumbullakët do të përfshijnë 41 komuna nga Ballkani Perëndimor, përfshirë Koordinatorin dhe Referentët për Çështjet Rome, aty ku ka, ministritë përgjegjëse për ndërtim dhe planifikim hapësinor, asociacionet e komunave, sipas nevojës, organizata joqeveritare dhe ekspertë të tjerë që punojnë në çështje të banimit.

Historik

Legjislacioni për legalizimin në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Përkufizimi i OSBE-së i vendbanimit të ndërtuar në mënyrë të paligjshme është “çdo vendbanim njerëzor ku banimi është ndërtuar pa leje të nevojshme apo titull ligjor për shfrytëzimin e tokës.”¹ Çështja e legalizimit të vendbanimeve joformale rome është një nga shqetësimet më urgjente e identifikuar në *Planin e Veprimit të OSBE-së të vitit 2003 për Përmirësimin e Gjendjes së Komunitetit Rom dhe Sinti përbrenda Fushëveprimit të OSBE-së*.² Në shumicën e juridiksioneve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, banimi ligjor është parakusht për përmbushjen e të drejtave tjera. Romët që jetojnë në vendbanime joformale kanë mungesë të qasjes së arsyeshme në tokën dhe pronën të cilën e kanë në shfrytëzim dhe prandaj janë të ekspozuar ndaj dëbimit. Gjithashtu, ata përballen me vështirësi në qasjen në regjistrin civil, arsim dhe shërbime të tjera publike. Zgjidhja e çështjeve të banimit dhe vendbanimit është e nevojshme për të luftuar marginalizimin dhe përjashtimin social.

Vendbanimet joformale rome janë të pranishme në të gjitha juridiksionet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në vitin 2002, Misioni i OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë identifikoi rreth njëqind vendbanime joformale të romëve në mbi tridhjetë komuna, me një popullatë prej rreth 22,000 personash. Në serbi, prej rreth 590 vendbanimeve rome, vlerësohet se rreth 35% janë të ndërtuara në mënyrë joligjore, gjersa rreth 35% të tjera janë kombinim i vendbanimit joligjor dhe ligjor.³

Çështja e legalizimit është komplekse dhe qasja e saj duhet të jetë shumëfaqëshe. Shumica e juridiksioneve në rajonin e Ballkanit Perëndimor tani kanë ndërmarrë hapa fillestarë duke miratuar legjislacionin dhe strategjitë përkatëse të cilat mundësojnë formalizimin e vendbanimeve të ndërtuara në mënyrë joligjore. Më 2006, Shqipëria miratoi Ligjin e parë për legalizime, urbanizim dhe integrim të ndërtimeve joformale. Më 2009, Serbia miratoi Ligjin për planifikimin dhe ndërtimin i cili përkufizon legalizimin pasues të objekteve të ndërtuara ilegalisht. Më 2011 vijoi miratimi i Ligjit për trajtimin e objekteve të ndërtuara ilegalisht në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Ligji për trajtimin e ndërtesave të ndërtuara ilegalisht në Kroaci. Kroacia aktualisht është në proces të miratimit të ndryshimeve në ligjin e saj për trajtimin e ndërtesave të ndërtuara ilegalisht. Mali i Zi është në proces të miratimit të Ligjit për legalizimin e objekteve joformale, gjersa Kosova* është në proces të miratimit të Strategjisë për rregullimin e vendbanimeve joformale. Ndonëse Bosnja dhe Hercegovina nuk ka ligj në nivel shtetëror, disa komuna kanë miratuar Vendime për legalizimin e objekteve të ndërtuara ilegalisht.

Në përgjithësi, duhet të merren parasysh katër kriteret kryesore për sa i përket planifikimit urban dhe legalizimit të vendbanimeve rome të ndërtuar në mënyrë joligjore:

- Statusi i planifikuar i tokës së uzurpuar;
- Pronësia e tokës apo të drejtat në shfrytëzimin e tokës;
- Lokacioni gjeografik i vendbanimit përkitazi me qendrën e qytetit; dhe
- Nëse vendbanimi është tonë publike urbane apo tokë jopublike.⁴

Në shumicën e rasteve romët duhet të legalizojnë banesat apo vendbanimet e tyre brenda proceseve të përgjithshme të legalizimit, të cilat vlejnjë për të gjithë popullsinë. Për t'i përmendur disa faktorë të rëndësishëm, ata përballen me pengesa në dorëzimin e aplikacioneve për legalizim për shkak të mungesës së dokumenteve të nevojshme (personale dhe pronësore), pagesa të konsiderueshme për

¹ Misioni i OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, *Raport për Vendbanimet Joformale të Romëve në Bosnje dhe Hercegovinë*, 2003, f. 3. <http://www.osce.org/node/14860>.

² Plani i Veprimit i OSBE-së për Përmirësimin e Gjendjes së Komunitetit Rom dhe Sinti brenda fushëveprimit të OSBE-së <http://www.osce.org/odihr/17554>.

³ Udhëzimet për Përmirësimin e Legalizimit të Vendbanimeve Joformale Rome. <http://www.romadecade.org/files/downloads/14th%20ISC/Guidelines%20ISC%204-5%20Sept%2008%20Macura.pdf>.

* Ky përcaktim është pa paragjykim në qëndrimet për statusin, dhe është në përputhje me 1244 (Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) dhe me Mendimin e GJND-së për Deklaratën e Kosovës për Pavarësi.

⁴ OSBE, *Banimit dhe Vendbanimet e Romëve në Evropën Juglindore*, 2006, <http://www.osce.org/odihr/23336>.

tarifa dhe certifikata të ndryshme dhe mungesë të edukimit. Disa qeveri qendrore dhe lokale kanë ndërmarrë hapa proaktivë në këtë fushë duke ulur tarifën e aplikimit dhe duke krijuar pozitën e Koordinatorëve Komunalë për Çështje Rome, të cilët mbështesin komunitetet lokale në marrjen e dokumenteve përkatëse. Të tjerat kanë ndërmarrë hapa edhe më të mëdhenj duke dhuruar tokë në lokacionet ku janë të vendosura vendbanimet romë, duke investuar në përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e qasjes në shërbimet publike (përfshirë grumbullimin e mbeturinave, ndriçimin publik, transportin publik, policinë, etj.) dhe duke ofruar programe sociale të integritit. Ky lloj i qasjes së integruar është i nevojshëm jo vetëm për të siguruar që të gjithë janë në gjendje të marrin pjesë në procesin e legalizimit, por edhe për të promovuar integrimin social dhe ekonomik të komunitetit rom.

Shembull i legalizimit: vizitë studimore në qytetin Sisak, Kroaci

Më 2005, vendbanimi i *Capraške poljane* në qytetin Sisak ishte vendbanim joformal i ndërtuar në tokë e cila ishte në pronësi të Ndërmarrjes Pyjore të Kroacisë. Ajo ishte tokë publike urbane dhe nuk ishte e planifikuar për përdorim banesor. Me qëllim të ofrimit të zgjidhjes së qëndrueshme të banimit për 150 familjet romë që shtëpi qanin *Capraške poljane*, qyteti Sisak avokoi për bartjen e tokës nën vendbanimin rom nga Republika e Kroacisë në qytetin Sisak.

Sigurimi i tokës ishte hapi i parë në legalizimin e vendbanimit joformal. Qyteti Sisak pastaj ndryshoi planet e qytetit për urbanizëm dhe ndërroi destinimin e tokës nga tokë publike urbane në tokë jopublike banesore. Veç kësaj, qyteti Sisak zhvilloi planet të hollësishme të vendbanimit. Kjo bëri të mundur që qyteti të ofrojë qasje formale në shërbime infrastrukturore siç janë uji, energjia elektrike, dhe grumbullimi i mbeturinave. Me këtë nismë, qyteti Sisak formalizoi vendbanimin joligjor dhe bëri të mundur që banorët e vendbanimit të fillojnë procesin e legalizimit të shtëpive të tyre të ndërtuar ilegalisht.

Ju lutem keni parasysh se gjatë kësaj vizite studimore do të ofrohet përkthim në gjuhën maqedonase dhe shqipe.

Politikat e banimit social në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Organizata Catholic Relief Services përkufizon banimin social si “banim të financuar, ndërtuar dhe/apo dhuruar nga Qeveria, si dhe përgjithësisht është i synuar për grupet me të ardhura të ulëta apo pa të ardhura fare. Banimi social zakonisht shoqërohet me një qira të përbalueshme, dhe pronari i pronës e paguan atë përmes kredive apo huave me kamata të ulëta. Brenda standardit të kushteve të tregut, banimi social ofrohet për personat me financa apo të ardhura të kufizuara.”⁵

Shumica e juridiksioneve në Ballkanin Perëndimor posedojnë një formë të strategjive apo ligjeve që rregullojnë banimin social dhe/apo të përbalueshëm. Më 2001, Kroacia miratoi një program të Ndërtimit Banimit me Financim Publik në pajtim me Ligjin për ndërtimin e banimit me financim publik, i cili i jep përparësi shtetasve që jetojnë në vendbanime të cilat nuk janë në pronësi të tyre. Më 2004, Shqipëria miratoi Ligjin për banimin social. Më 2009, Serbia miratoi Ligjin për banimin social, pas një miratimi të mëhershëm të Strategjisë për Zvogëlimin e Varfërisë në Serbi dhe Strategjisë Kombëtare për Zgjidhjen e Çështjeve të Refugjatëve dhe Personave të Zhvendosur të Republikës së Serbisë. Më 2010, Kosova* miratoi Ligjin për financimin e programeve speciale të banimit, që rregullon banimin social. Qeveria e Malit të Zi aktualisht është në proces të miratimit të Ligjit për banimin social.

Gjersa nuk është miratuar asnjë ligj formal për banimin social në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, më 2010 kjo qeveri miratoi Strategjinë Kombëtare për Uljen e Varfërisë dhe Përfshirjen Sociale, e cila trajtonte personat që përballen me përjashtim social në sektorin e banimit. Ngjashëm, Bosnja dhe Hercegovina nuk ka asnjë kornizë ligjore për banimin social, por qeveria ka realizuar disa projekte të zhvillimit të banimit social me mbështetje të Catholic Relief Services, UNDP dhe Hilfswerk Austria.

⁵ Catholic Relief Services, *Rekomandimet për zhvillimin e banimit jofitimprurës /social në BeH*, tetor 2011 f. 42.

* Ky përcaktim është pa paragjykim në qëndrimet për statusin, dhe është në përputhje me 1244 (Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) dhe me Mendimin e GJND-së për Deklaratën e Kosovës për Pavarësi.

Në përgjithësi, ofrimi i banimit për grupet e cenueshme sociale duhet të kuptohet si kombinim i disa elementeve: sigurimi i njësisë së banimit; integrimi i grupeve të cenueshme; dhe përmirësimi i kushteve të jetës së grupeve të caktuar.⁶ Duke promovuar këmbim të përvojave, PMIR synon t'i mbështesë qeveritë në angazhimet që sigurojnë se romët kanë qasje në banim social dhe se ofrimi i tij shoqërohet me politikat tjera të integritit.

Zhvillimi i banimit dhe përmirësimet në vendbanime

Në raportin e kohëve të fundit të publikuar nga Komisioni Evropian⁷, komuniteti rom kryesisht jeton në lagje të integruara urban/periferike; lagje të ndara urbane/periferike; dhe vendbanime të ndara rurale. Ekziston një mungesë e infrastrukturës bazike, siç janë trotuarët apo energjia elektrike apo uji i pijshëm. Veç kësaj, njësitë e banimit janë të cilësisë së ulët, shpeshherë kasolle të improvizuara me hapësira të kufizuara dhe pa dritare, dyer apo mure⁸. Për më tepër, pjesëtarët e komunitetit rom që jetojnë në vendbanime të ndara rurale shpeshherë nuk vijojnë shkollimin, nuk përfitojnë nga shërbime shëndetësore dhe shërbime të tjera sociale.

Sipas nenit 11 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁹ e ratifikuar nga qeveritë e rajonit në Ballkanin Perëndimor, autoritetet kanë obligim ligjor për të siguruar banim adekuat për të gjithë shtetasit e tyre. Përderisa Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore nuk ofron përkufizim të “banimit adekuat”, agjencitë si UN-Habitat përkufizojnë “banimin adekuat” si “më shumë sesa një kulm mbi kokë”. Sipas UN-Habitat “banimi adekuat” përfshin: privaci dhe hapësirë adekuate; qasje të lehtë fizike; siguri adekuate; siguri të zotërimit; stabiliteti dhe qëndrueshmëri strukturore; ndriçim adekuat, ngrohje dhe ventilim; infrastrukturë themelore: furnizim me ujë, kanalizim dhe grumbullim të mbeturinave; cilësi të përshtatshme mjedisore dhe faktorë përkatës shëndetësorë; dhe lokacion adekuate dhe të qasshëm për sa i përket punësimit dhe lehtësimeve bazike, të gjitha nga të cilat duhet të jenë në dispozicion në kosto të përballueshme. Shumica e juridiksioneve të Ballkanit Perëndimor kanë ndërmarrë disa aktivitete që kishin për qëllim përmirësimin apo zhvillimin e banimit për romët. Për shembull:

- Qeveria e Kroacisë është duke i realizuar tri projekte që kanë për qëllim përmirësimin e infrastrukturës në vendbanimet rome;
- Pas përfundimit të përpilimit të nevojave për banim për romët në vitin 2009, Bosnja dhe Hercegovina kanë realizuar dy projekte të banimit që kishin për qëllim ndërtimin dhe rindërtimin e shtëpive të romëve dhe projekte më të vogla infrastrukturore;
- Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ka realizuar një program të mikrokredive për familjet rome, që mundësonin përmirësimet në shtëpitë e tyre.

⁶ Catholic Relief Services, *Rekomandimet për zhvillimin e banimit jofitimprurës /social në BeH*, tetor 2011 f. 42.

⁷ Fresno, Jose Manuel, *Çka funksionon për përfshirjen e romëve në BE*, 2012,

http://ec.europa.eu/justice/discrimination/files/whatworksfor_romainclusion_en.pdf.

⁸ Sipas Anketës së UNDP 2012, *Gjendja e Romëve në 11 Shtetet Anëtare të BE-së: Rezultatet e Anketës në Vështrim* (http://ec.europa.eu/justice/discrimination/files/whatworksfor_romainclusion_en.pdf), rreth 45% e romëve jetojnë në ekonomi familjare që kanë mungesë të së paku një komoditeti bazik të banimit, gjegjësisht kuzhinë, tualet të brendshëm, dush të brendshëm apo banjë dhe energji elektrike.

⁹ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1966, <http://www2.ohchr.org/english/law/cescr.htm>.

Rindërtimi i rrjetit infrastrukturor: vizitë studimore në Qarkun Medjimurje, Kroaci

Qarku Medjimurje është vendi në të cilin jeton numri më i madh i romëve në Kroaci. Vlerësohet se rreth 11% të popullatës së këtij Qarku janë romë. Qarku Medjimurje identifikoi se shumica e popullatës rome kishte kushte joadekuat të jetesës; qoftë si rrjedhojë e mungesës së infrastrukturës në vendbanimet rome apo mungesës së kushteve adekuat të shtëpive individuale.

Bashkë me Zyrën Qeveritare për Pakica Kombëtare, Qarku Medjimurje siguroi financim për disa projekte infrastrukturorë dhe të banimit, duke përfshirë:

- “Rindërtimin e rrjetit infrastrukturor (ujë, kanalizim dhe energji elektrike) për vendbanimin Parag” (PHARE 2005);
- “Rindërtimin e rrjetit infrastrukturor (ujë, kanalizim dhe energji elektrike) për vendbanimet Pribislavec, Piškorovec dhe Lončarevo” (PHARE 2006);
- “Rindërtimin e rrjeteve infrastrukturorë në vendbanimet Orahovica dhe Sitnice dhe nisjen e procesit të legalizimit” (IPA 2008).

Të tre projektet kishin për qëllim përmirësimin e standardeve të jetës së komuniteteve rome në Qarkun Medjimurje dhe integrimin e mëtejshëm dhe përfshirjen e romëve.

Ju lutem keni parasysh se gjatë kësaj vizite studimore do të ofrohet përkthim në gjuhët boshnjake/kroate/malazeze/serbe.

Në përgjithësi, zhvillimi i banimit dhe përmirësimet e vendbanimeve brenda komunitetit rom duhet të kryhet në pajtim me 10 Parimet Themelore për Përfshirjen e Romëve¹⁰ të cilat, mes tjerash, përfshijnë përdorimin e instrumenteve të Bashkimit Evropian dhe pjesëmarrjen aktive të romëve.

Pozita e cenueshme e grave dhe fëmijëve rome

Raporti i Raportuesit Special për banimin adekuat si komponentë e së drejtës në standard adekuat të jetës, dhe për të drejtën në mosdiskriminim, gjatë shqyrtimit të realizimit të të drejtave të grave në banim adekuat është informuar lidhur me diskriminimin e shumëfishtë në të cilin nënshtrohen gratë nga pakicat, e në veçanti gratë rome, duke ndikuar negativisht në të drejtat e tyre. Sipas këtij raporti “dëshmitë tregonin se shume gra i janë nënshtruar niveleve të shumëfishta të diskriminimit brenda komunitetit dhe nga Shteti për shkak të faktit se ato ishin gra, si dhe pjesëtare të një grupi pakicë.”¹¹ Për më tepër, raporti tregon se, “diskriminimi i shumëfishtë, sipas raportimeve të shumta, ka çuar në situatë ku gratë jetojnë në banim joadekuat, kushte të degraduara të jetesës, si dhe në komunitete të ndara, të cilat nuk përfitojnë nga shërbimet bazike siç është uji, kanalizimi apo ngrohja.”

Raporti i publikuar nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve¹² nënvizon Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e cila obligon Shtetet “që të ndalin dhe eliminojnë diskriminimin racor në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën për të gjithë [...] për të qenë të barabartë para ligjit, gjegjësisht të gëzojnë [...] të drejtë në banim.”¹³ Më tej, ai përkufizon traktatet ndërkombëtare të cilat përcaktojnë trajtimin e grupeve të cenueshme, siç janë gratë dhe fëmijët, si dhe të drejtat e tyre në banim, siç është Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit nda Gruas, e cila rregullon si në vijim:

Këto palë do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për eliminimin e diskriminimit ndaj grave në viset rurale për të siguruar se, në bazë të barazisë së burrave dhe grave, ato marrin pjesë dhe përfitojnë nga zhvillimi rural dhe, veçanërisht, të sigurojnë se këto grat kanë të drejta për [...] të

¹⁰ Këshilli i Evropës, *10 Parimet Themelore për Përfshirjen e Romëve*, 2011,

http://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Documents/2011_10_Common_Basic_Principles_Roma_Inclusion.pdf.

¹¹ Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore: Gratë dhe banimi adekuat. Raporti i Raportuesit Special për banim adekuat si komponentë e së drejtës në standard adekuat të jetës dhe e për të drejtën në mosdiskriminim, Miloon Kothari. E/CN.4/2006/118. 27 shkurt 2006.

¹² Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve. Standardet nuk aplikohen: Banimi joadekuat në komunitetet rome. Dhjetor 2010.

¹³ Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor. Neni 5 (e) (iii).

<http://www2.ohchr.org/english/law/cerd.htm>

gëzuar kushte adekuate të jetës, posaçërisht në lidhje me banim, kanalizim, energji elektrike dhe furnizim me ujë, transportim dhe komunikim.¹⁴

Neni 27 i Konventës për të Drejtat e Fëmijës sqaron se Shteti është përgjegjës për të ndihmuar dhe mbështetur prindërit apo kujdestarët në fushën e banimit, nëse është e nevojshme për të siguruar standard adekuat të jetës për fëmijën.¹⁵

Komisionari i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut¹⁶ pranon se shkelja e së drejtës në banim adekuat mund të ketë domethënie të ndryshme për gratë dhe burrat, duke përcaktuar se:

Gratë zakonisht bartin përgjegjësinë kryesore për mirëmbajtjen dhe përkujdesjen për shtëpitë, dhe është me rëndësi që ky rol kritik të pranohet dhe të drejtat e tyre të avancohen. Të kuptuarit e banimit adekuat për gratë duhet të merr parasysh kontekstin dhe kushtet e banimit dhe jetesës së komunitetit dhe familjes në të cilën ato jetojnë. Ndikimi i kushteve joadekuate të jetës dhe mungesës së shtëpisë në fëmijë është po aq i rëndësishëm për nënat e tyre. Jetët e shumë grave janë thellësisht të lidhura me ato të familjeve dhe fëmijëve të tyre.

Për këto arsye Raportuesi Special ka rekomanduar që Shtetet të sigurojnë aplikimin e politikave dhe legjislacionit të banimit të ndjeshme në aspektin gjinor, duke marrë parasysh situatën e grupeve specifike të grave të cilat janë veçanërisht të cenueshme ndaj mungesës së shtëpisë dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të banimit për shkak të formave të shumta të diskriminimit.

Dokumente referencë

Legalizimi:

- Qeveria e Shqipërisë, Ligji për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve joformale, 2006
- Qeveria e Serbisë, Ligji për planifikim dhe ndërtim, 2009
- Qeveria e ish Republikë Jugosllave të Maqedonisë, Ligji për trajtimin e objekteve të ndërtuara ilegalisht, 2011
- Qeveria e Kroacisë, Ligji për trajtimin e ndërtesave të ndërtuara ilegalisht, 2011 (aktualisht në proces të ndryshimit)
- Qeveria e Malit të Zi, Ligji për legalizimin e objekteve joformale
- Qeveria e Kosovës*, Projekt-strategjia për rregullimin e vendbanimeve joformale, 2012
- Bosnja dhe Hercegovina nuk ka ligj në nivel shtetëror, por disa komuna kanë miratuar Vendime për legalizimin e objekteve të ndërtuara ilegalisht.

Banimi social:

- Qeveria e Kroacisë, Programi për ndërtimin e banimit me financim publik, 2001
- Qeveria e Shqipërisë, Ligji për banimin social, 2004
- Qeveria e Serbisë, Ligji për banimin social, 2009, dhe Strategjia Kombëtare dhe Plani i veprimit për banim social, 2012
- Qeveria e Kosovës*, Ligji për financimin e programeve të banimit special, 2010
- Qeveria e Malit të Zi, projektligji për banimin social, 2012
- Gjersa nuk është miratuar asnjë ligj formal për banimin social në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, më 2010 kjo qeveri miratoi Strategjinë Kombëtare për Uljen e Varfërisë dhe Përfshirjen Sociale, e cila trajtonte personat që përballen me përjashtim social në sektorin e banimit
- Bosnja dhe Hercegovina nuk ka asnjë kornizë formale strategjike apo ligjore për banimin social, por qeveria ka realizuar disa projekte të zhvillimit të banimit social me mbështetje të Catholic Relief Services, UNDP dhe Hilfswerk Austria.

¹⁴ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas. Neni 14(2). <http://www2.ohchr.org/english/law/cedaw.htm>.

¹⁵ Konventa për të Drejtat e Fëmijës. <http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm>.

¹⁶ KiE. Komisionari për Çështje të të Drejtave të Njeriut. Dokument i qëndrimit: të drejtat e banimit: Obligimi për të siguruar banim për të gjithë. 25 prill 2008. <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1292391>.

Kornizat ndërkombëtare:

- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, 1966, <http://www2.ohchr.org/english/law/cescr.htm>
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, 1969. <http://www2.ohchr.org/english/law/cerd.htm>
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, 1979. <http://www2.ohchr.org/english/law/cedaw.htm>
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës, 1990. <http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm>
- Plani i Veprimit i OSBE-së për Përmirësimin e Gjendjes së Komunitetit Rom dhe Sinti në Fushëveprimin e OSBE-së, 2003, <http://www.osce.org/odihr/17554>
- Këshilli i Evropës, *10 Parimet Themelore për Përfshirjen e Romëve*, 2011, http://www.coe.int/t/dg4/youth/Source/Resources/Documents/2011_10_Common_Basic_Principles_Roma_Inclusion.pdf